



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 27.10.2021**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1440\_2021**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke marrë parasysh:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.10, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës **31.08.2021** për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, të bërë nga ndërmarrja **“HEP Energjia” Sh.P.K.**, adresa: **Rr. Luan Haradinaj, Hyr.1-2, Nr.21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.**

**në seancën e mbajtur me datë 27 tetor 2021 nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes **“HEP Energjia” Sh.P.K.**, me numër Licence **ZRRE/Li\_83/21**, për periudhën kohore prej 27.10.2021. deri me 26.10.2026.
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **“HEP Energjia” Sh.P.K.**, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

## **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë **31.10.2021** ka pranuar nga ndërmarrja **“HEP Energjia” Sh.P.K.**, Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të **Furnizimit me energji elektrike në Kosovë.**



- Rregulatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja “HEP Energjia” Sh.P.K., me datë 15 tetor 2021 ka njoftuar përmes gazetës palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditë kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregulatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- Rregulatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- “HEP Energjia” Sh.P.K., ka pasur licence për furnizim me energji elektrike të lëshuar nga Bordi i Rregullatorit për Energji, me numër licence ZRRE/Li\_43/15, me afat prej 14.10.2016-13.10.2021. Përfaqësues të kësaj ndërmarrjeje gjatë aplikimit kanë kërkuar vazhdim licence, mirërpo Bordi i Rregullatorit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Nenit 19 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, aplikacionin e ka konsideruar si aplikim i ri e jo vazhdim licence.
- Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- Rregulatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes “HEP Energjia” Sh.P.K., dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes HEP Energjia Sh.P.K., dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


**Bordi i Rregullatorit:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar